

Tiranë më, 18/02/2022

NJOFTIM
Për përfituesit e kontraktuar nën IPARD II

Bazuar në Marrëveshjen Sektoriale, të ndryshuar; Programit IPARD II 2014-2020; Ligji Nr. 44/2015 “Kodit të Procedurave Administrative”; VKM Nr.719/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar; Kontratës së Grantit të nënshkruar ndërmjet Autoritetit Kontraktues/AZHBR dhe përfituesve të grantit nën programin IPARD II:

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, njofton të gjithë përfituesit, të cilët kanë nënshkruar një Kontratë Granti me AZHBR, se për çdo ndryshim, që lidhet me investimin e mbështetur nga fondet që menaxhohen nga Agjencia dhe që prekin të dhënat e deklaruara në momentin e aplikimit, në bazë të të cilave është lidhur kontrata, si dhe ndryshime të cilat prekin kushtet e kontratës së nënshkruar:

Duhet ti njoftohen paraprakisht Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

KUJDES: Ndryshimet të kryera pa njoftuar më parë Autoritetin Kontraktues, mund të përbejnë shkak për zgjidhjen e Kontratës.

<Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
Rruga “Muhamet Gjolleša”, Nr.56
Tiranë, Shqipëri>